

TEZA 21

I. Shënoni me V shprehjet e vërteta dhe me X ato që janë të gabuara

- _____ 1. Kontrata mund të zgjidhet pavarësisht nëse mospërmbushja e detyrimit prej njërs nga palët ka rëndësi të pakët për interesat e palës tjetër.
- _____ 2. Personi që është shpallur i zhdukur, mund të shpallet i vdekur me vendim të gjykatës, kur kanë kaluar pa patur lajme dy vjet nga dita që është shpallur i zhdukur.
- _____ 3. Përgjegjësia e prodhuesit ulet kur dëmi është rrjedhim i përbashkët i të metave të produktit dhe sjelljes së një të treti.
- _____ 4. Kur ka kaluar afati brenda të cilit do të ekzekutohej detyrimi, debitori duhet të vihet në vonesë me anë të një njoftimi me shkrim.
- _____ 5. Pala porositëse nuk mund të caktojë dy agjentë për rrethin e Tiranës.
- _____ 6. Me përfaqësim një person kryen, brenda tagreve që i janë dhënë nga gjykata veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik.
- _____ 7. Pronësia mbi sendet e luajtëshme fitohet me anë të kontratës, me kusht që të bëhet edhe dorëzimi i tij
- _____ 8. Kur në prokurën e posaçme është vendosur një klauzolë e parevokueshmërisë së saj, i përfaqësuari nuk mund ta shfuqizojë atë.
- _____ 9. Kur sendi që kërcohët të pjestohet është shtëpi banimi, gjykata nuk e peston atë por, ia lë në pjesë bashkëpronarit që banon në atë shtëpi ose ka nevojë më shumë se të tjerët për atë sipërfaqe banimi.
- _____ 10. Nëse sendet e lëna peng shpronësohen për interesa publike, kreditorët që janë të siguruar me peng, kanë të drejtë të paguhen me preferim, sipas rradhës së preferimit që kanë patur kreditë e tyre, nga nga çmimi i shpronësimit të tij. (10 pikë)

II. Plotësoni fjalitë dhe jepni sqarimet e mëposhtme:

a. Dhuruesi është përgjegjës për mospërmbushjen ose vonesën në dhurim _____

b. Kontrata e komisionit nënkuption _____

c. Pavlefshmëria absolute e veprimeve juridike nënkuption _____



E drejta civile

d. Testamenti ollograf eshtë _____

$$(10 \text{ pikë} = 2+3+3+2)$$

III. Shpjegoni ndryshimin koncepteve apo instituteteve të mëposhtme:

a. Cilat janë dallimet midis padisë së kthimit të sendit dhe padisë mobuese?

. (10 píkë)

IV. Emërtoni definicionet e mëposhtme duke dhënë konceptin përkatës.

a. Kontrata e lidhur nga dy palë, kur një person i tretë përfiton prej saj quhet

b. Ngjarja e parashikuar në kontratën e sigurimit, që në qoftë se vërtetohet, sjell detyrimin e siquruesit që të shpërblejë dëmin guhet

c. Kontrata ku njëra palë merr përsipër të transportojë persona nga njëri vend në një vend tjetër quhet

d. Cilido që ka bërë një pagim të padetyruar ka të drejtë të kërkojë kthimin e asaj që ka paguar si dhe të gëzojë frytet dha kamatat nga dita e pagimit, nëse personi që ka marë pagesën është në keqëbesim, dhe nga nga dita e kërkesës për kthimin, kur personi është në mirebesim. Ky është definicion i (10 pikë=3+2+2+3)

V. Jepni shpiegimet e mëposhtme:

a. Si grupohen shpenzimet e zakonshme me shpenzimet e domosdoshme tek kontrata e girasë? Kush e mban përgjegjësinë për to?




E drejta civile

b. Nga çfarë përbëhet dëmi që duhet të shpërblejë debitori për mosekzekutimin e detyrimit?

c. Çfarë mund të kërkojë kreditori në rast të mangësive të debitortit në përm bushjen e detyrimeve?

d. Cilat janë llojet e Prokurës:



. (10 pikë=4+2+2+2 pikë)



TEZA 11

E DREJTE PENALE

1. Po/ Jo (1 pike secila pyetje). Shenoni me shenjen plus (+) poimin dhe, me shenjen minus (-) mohimin. Gjithsej 10 pike.

- a. A ndikohet gjykata ne castin e caktimit te denimit penal ndaj te pandehurit nga vendi ku eshte kryer vepra penal? _____
- b. A ndalon ligji ynë penal që pjestori i organizates kriminale te perjashtohet teresish nga denimi penal? _____
- c. A urdherohet nga gjykata qe i pandehuri te mos drejtoje automjete, neni 37 i Kodit Penal, sepse ajo cmon se ai, pasi ka kryer nje vjedhje, ky denim plotesues do te kete efekt parandalues? _____
- d. A permban neni 82 i Kodit Penal, " vrasja e kryer ne gjendje te tronditjes se forte psikike" elementin "kohe"? _____
- e. A eshte i qenesishem per gjykaten identifikimi i motivit qe ka shtyre autorin e vepres penale kur ai kryen vrasje me paramendim? _____
- f. A eshte e pjese perberese e nenit 7/a, Juridikioni Universal, korruptioni aktiv i nepunesve te huaj, neni 244/a te Kodit Penal? _____
- g. A konsiderohet pjese perberese e vepres penale te korruptionit aktiv i personave qe ushtrojne funksione publike, neni 244 Kodit Penal, perfitimi jomaterial? _____
- h. A ka perqejgesi penale avokati qe nuk kallzon nje krim qe do te kryet ne te ardhmen nga klienti i tij dhe qe ka marre dijeni nga sherbimi informues i zyres se tij? _____
- i. A ka perqejgesi penale motra e nje autorin vepre penale nese ajo strehon ate pasika kryer nje krim me qellimin qe ti shpetoje kerkimit apo arrestimit nga policia? _____
- j. A do te konsiderohet veper penale e vjedhjes rasti kur i pandehuri ka vjedhur nje send, jo nga pronari apo poseduesi i ligjshem, por nga nje person qe me pare e kish vjedhur ate? _____

2. Beni krahasim :

Te perbashketat dhe dallimet qe permbyne konceptet e "dashjes se drejtperdrejte" dhe "dashjes se terthorte". (10 pike)





3. Arsyetoni nese do te konsideroni si vepra penale qe konkurojne me njera tjetren, shperdorimi detyres (neni 248) Kodit Penal me fallsifikimin e dokumentit te kryer nga personi qe ka per detyre ta leshoje ate, neni 186 Kodit Penal, kur fakti penal permblidhet ne dokumentin e fallsifikuar ? (10 pike)



- EDUKIM PER DREJTEN
4. Shpjegoni rendesine e elementit "i denuar me pare" ne permbajtjen e ligjit penal material shqiptar. Shihni kete kategori ne te gjitha planet dhe efektet qe sjell ai, si perkunder denimit penal ashtu edhe si element i rendesishem qe kushtezon dispozita te Pjeses se Posacme te Kodit Penal. (10 pike)



5. Germa "i" ? e nenit 50 te Kodit Penal, rrethanat renduese, parashikon se "...vepra penale eshte kryer duke perdonur arme...". A do te zbatonit kete rrethane renduese ndaj nje personi qe akuzohet per vrasje dhe armembajtje pa leje ? (10 pike)



TEZA 18
PROCEDURË PENALE

I. Shënoni me V ose G, përkatësisht përgjigjen e vërtetë ose të gabuar (çdo përgjigje e saktë - 1 pikë; gjithsej – 5 pikë):

1. Padia civile në procesin penal mund të ngrihet përderisa nuk ka përfunduar shqyrtimi gjyqësor.
2. Gjykata merr vendim pafajësie edhe në rastin kur shkaku që e shuan veprën penale është i dyshimtë.
3. I pandehuri, i cili pasi është paraqitur largohet nga salla, konsiderohet i pranishëm, edhe në mungesë të mbrojtësit.
4. Heqja dorë me afat nga e drejta e ankimit është e pavlefshme.
5. Pasi i është dhënë fund shqyrtimit gjyqësor, në asnjë rast nuk mund të merren prova të reja.

II. Vendosni shenjën “+” ose “x” tek alternativa e saktë (çdo përgjigje e saktë - 2 pikë; gjithsej – 10 pikë):

1. Lidhur me sekretin e hetimeve paraprake **nuk** është i vërtetë pohimi:

- publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete është i ndaluar;
- aktet josekrete lejohet të publikohen, por pasi të kenë përfunduar hetimet paraprake;
- në raste të veçanta, gjykata mund të lejojë publikimin e gjeneraliteteve të të miturit;
- prokurori mund të vendosë ruajtjen e sekretit edhe pas përfundimit të hetimeve;
- aktet e hetimeve janë sekrete përderisa viktima nuk është njohur me to.

2. Lidhur me aktet e procesit penal, **nuk** është i vërtetë pohimi:

- aktet e kryera gjatë seancës gjyqësore dokumentohen nëpërmjet registrimit audio/audioviziv, por vetëm kur ka mundësi teknike;
- nëpërmjet registrimit audio/audioviziv mund të dokumentohet edhe çdo akt tjetër, i kryer gjatë hetimeve paraprake;
- regjistrimi i seancës gjyqësore bëhet nga sekretari gjyqësor, i cili udhëzohet dhe mbikëqyret nga kryetari i trupi gjyques;
- në asnjë rast procesverbali nuk mund të mbahet në mënyrë të përbledhur, me shtypshkrim ose me doreshkrim;
- siglimi nga kryetari i trupit gjyques nuk është kusht për vlefshmérinë e procesverbalit të mbajtur në mënyrë të përbledhur.

3. I pandehuri në një procedim të lidhur lejohet të dëshmojë në cilësinë e dëshmitarit:

- kur akuza ndaj tij është pushuar;
- kur është dekluarar i pafajshëm me vendim të formës së prerë;



- kur është dënuar me vendim penal të formës së prerë;
 - kur është gjykuar sipas gjykimit me marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit;
 - kur çështja në ngarkim të tij është pushuar.

4. Është i detyruar që të dëshmojë në procesin penal:


- bashkëshorti për faktet e mësuara nga i pandehuri gjatë jetës bashkëshortore; ish-bashkëjetuesi i të pandehurit, për fakte të mësuara nga i pandehuri gjatë bashkëjetesës; fëmija e të pandehurit, kur nëna e tyre ka paraqitur kallëzim ndaj të pandehurit;
 - bashkëshorti që ka zgjidhur martesën, për faktet e mësuara nga i pandehuri gjatë jetës bashkëshortore;
 - fëmija i biresuar nga i pandehuri.

5. Lidhur me marrjen e procesverbaleve të provës të procedimeve të tjera penale, është i vërtetë pohimi:

- mund tē pērdoren nē shqyrtimin gjyqësor vetëm me pēlqimin e tē pandehurit;
 - lejohet tē merren vetëm ato procesverbale që kanë tē bëjnë me sigurimin e provës gjatë hetimeve paraprake;
 - mund tē pērdoren kundër tē pandehurit, edhe kur gjatë marrjes së tyre nuk ka qenë i pranishëm mbrojtësi i tij;
 - marrja e deklarimeve tē tē pandehurit lejohet nē çdo rast;
 - palët nuk kanë tē drejtë tē kërkojnë pyetjen e personit, dëshmia e tē cilit është dhënë në një procedim tjetër.

III. Pyetje konceptuale (2 pyetje, 10 pikë)

1. Cilat janë rregullat për pyetjen në seancë gjyqësore të të miturit nën moshën 14 vjeç? (5 pikë)



2. Cilat janë rregullat që duhen zbatuar kur lind nevoja të kryhet sekuestrimi i një llogarie bankare? Cili është parakushti që duhet plotësuar dhe a mund të kryhet akti nga oficeri i policisë gjyqësore, me nismën e tij? (5 pikë)

IV. Pyetje krahasuese (15 pikë)

1. Cili është dallimi mes “*akuzës për një fakt të ri penal*” dhe “*akuzës për një vepër tjeter*”? Ilustrojeni përgjigjen tuaj me anën e një shembulli.



V. Pyetje zhvilluese (10 pikë):

1. Cili është kuptimi i sigurimit të dëshmisë si provë dhe në cilat raste zbatohet ai? Cila është gjykata e caktuar me ligj që duhet të procedojë me marrjen e dëshmisë? Cili është rregulli që lejon përdorimin e saj në shqyrtimin gjyqësor?



PROCURERË CIVILE

TEZA 3

1. Përeaktoni nëse, pohimet e mëposhtme janë të vërteta apo të gabuara (shënoni me V- e vërtetë dhe X – e gabuar)

- Personi, që paraqet dhe përdor si mjet provues një shkresë, që ka ndryshime, nuk duhet të vërtetojë se ndryshimet janë bërë nga ai, që e ka nxjerrë shkresën.
- Personi, që paraqet dhe përdor si mjet provues një shkresë, duhet të vërtetojë se ndryshimet janë bërë nga ai, që mund të shërbejë si provë.
- Njoftimi i akteve, që vijnë nga organet e një shteti të huaj në një drejtim të përcaktuar nga autoritetet e këtij shteti, kryhet me dorëzimin e tyre të thjeshtë sipas rregullave të caktuara në këtë kod.
- Për njoftimin e akteve të shteteve te huaj, pala që kërkon njoftimin duhet të shoqërojë kërkesën me shpenzimet e nevojshme të njoftimit.

8 pikë

2. Rrumbullakosni përgjigjen e saktë:

- Personi, që paraqet dhe përdor si mjet provues një shkresë, që ka ndryshime, duhet të vërtetojë se ndryshimet janë bërë nga ai, që e ka nxjerrë shkresën ose nga ai, që i ka kaluar e drejta.
- Personi, që paraqet dhe përdor si mjet provues një shkresë, nuk duhet të vërtetojë se ndryshimet janë bërë nga dikush tjeter me porosi të tyre.
- Shkresa private mund të provohet si origjinale, vetëm me prova të tjera shkresore

4 pikë


3. Nëse pala paraqet “filma fotografikë ose filma kinematografikë, kasetë të çdo lloji, si dhe çdo lloj tjeter regjistrimi” a mund të pranohen nga gjykata si provë për ngjarjet ose sendet që janë regjistruar në to ? Nëse po, kur?

4 pikë

4. Shpjegoni cilat janë llojet e pohimit gjyqësor dhe jepni për secilin lloj dy shembuj, që i konkretizojnë ato në praktikë:

10 pikë

5. Jepni përcaktimin (përkufizimin) se çfarë quhen “prezumime” në procesin gjyqësor civil si dhe tregoni sa lloj prezumimesh kemi?



PROCEDURË CIVILE

8 pikë

6. A mundet gjykata kryesisht të bëjë cilësimin e fakteve dhe veprimeve, që lidhen me mosmarrëveshjen në mënyrë të ndryshme nga ai që kanë propozuar palët? Përgjigjuni me po ose jo, pa e arsyetuar.

A mundet gjykata kryesisht ta cilësojë padinë e paditësit nga padi për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë (nenet 296/301 i Kodit Civil) në padi, që rrjedh nga detyrimet e lindura nga kontrata e qerasë, kur gjatë gjykimit provohet se padia e paditësit nuk është padi revendikimi, por padi që rrjedh nga kontrata e qerasë? Përgjigju me po ose jo dhe arsyeto shkurt përgjigjen.

10 pikë

7. Jepni përkufizimin sipas K.Pr.C. kur një provë quhet fillim prove me shkresë:

6 pikë



E drejta Familjare

TEZA 1

- I. Shënoni vlerësimin tuaj për pohimet/mohimet më poshtë përkatësisht me V 'vërtetësinë' dhe me G 'pavërtetësinë' e tyre në kolonën e dytë (çdo përgjigje e saktë vleresohet 1 pikë)

1. Fëmija i lindur jashtë martese, si rregull, merr mbiemrin e nënës.	
2. Padia për rastet e pavlefshmërisë absolute të martesës mund të ngrihet edhe pas zgjidhjes së martesës.	
3. Kujdestari nuk mund të birësojë personin që ka pasur në kujdestari.	
4. Sipas Kodit të Famijes, nëna e fëmijës mund të kundërshtojë me padit atësinë e prezumuar të fëmijës së lindur gjatë martese.	
5. Detyrimi për ushqim i pakzekutuar, pushon me vdekjen e personit të detyruar.	
6. Sipas kodit të Famijes fëmija nuk merr për mbiemër sëbashku edhe mbiemrin e nënës edhe atë të atit.	
7. Kushdo që merr njoftim për mbetjen e fëmijës pa prindër ose për lindjen e një fëmije me prindër të panjohur mund të kërkojë gjyqësisht vendosjen e tij në kujdestari	
8. Bashkëshortët mund të disponojnë banesën bashkëshortore dhe pajisjet e saj pa pëlqimin e tjetrit	
9. Kodi i familjes parashikon në mënyrë të vecantë marrëdhënie vetjake të gjyshërvë me nipërit e mbesat.	
10. Detyrimi për ushqim mund të shlyhet me kreditin që personi i detyruar ka kundrejt përfituesit.	

- II. Pyetje me alternativa: Rrumbullakos pergjigjen sipas kërkësës (çdo përgjigje e saktë vleresohet 2 pikë).

1. Është e saktë se amësia dhe atësia në rastin e ngatërrimit të pavullnetshëm të fëmijës, mund të vërtetohet me vendim gjyqësor kur:
 - a. Kërkohet njohja e një identiteti të ndryshëm të fëmijës;
 - b. Fëmija është regjistruar me emër të rremë;
 - c. Në aktin e lindjes nuk është shënuar emri i nënës.
 - d. Asnjë nga rastet më sipër.
2. Autoriteti përpara të cilit bëhet kundershtimi i lidhjes së martesës është:
 - a. Nëpunësi i gjendjes civile;
 - b. Gjykata;
 - c. Prokurori;
 - d. Notari.
3. I mituri që lejohet të lidhë martesë nën moshë ka për regjim pasuror:
 - a. Cilindo regjim që parashikon Kodi i Familjes;
 - b. Regimin e pasurive të ndara;
 - c. Regimin e bashkësisë ligjore;
 - d. Regimin e bashkësisë me kontratë.
4. Ka të drejtë të kërkojë në gjykatë masa urgjente nëse njeri bashkëshort nuk plotëson në mënyrë të dukshme detyrimet e tij dhe vë në rrezik interesat e familjes:
 - a. Prokurori;
 - b. Psikologu;
 - c. Bashkëshorti tjetër;
 - d. Fëmijët.



5. Nëse regjimi me kontratë nuk është zgjedhur para lidhjes së martesës, bashkëshortët me pëlqim mund ta kërkojnë atë pér interes të familjes:

 - a. 1 vit pas lidhjes së martesës;
 - b. 2 vjet pas lidhjes së martesës;
 - c. 6 muaj pas lidhjes së martesës
 - d. Në çdo kohë pas lidhjes së martesës

III. Jepni kuptimin e saktë lidhur me :

- 1. "Parim i prezumimit të atësisë" [5 pikë]**

IV. Bëni krahasimin e:

- IV. BEMI KRAVASHIMI I:

 - Detyrimit për ushqim midis vëllezërve dhe motrave me detyrimin e prindërve kundrejt fëmijëve të tyre [10 pikë]

V. Listoni:

1. Hapat që ndiqen për të përllogaritur kontributin kompensues [5 pikë]

Handwriting practice lines for the letter 'a'.



- VI. **Analizoni/përshkruani** Cilat janë rastet e parashikuara nga Kodi i Familjes lidhur me pavlefshmërinë e martesës të cilat kanë elemente të përzier të pavlefshmërisë absolute me atë relative? [10 pikë]





KAZUS 4⁵

Rrethanat e faktit

Paditësja S.M ka kërkuar me padi: Shpërblimin e dëmit dhe ndalimin e ushtrimit të aktivitetit në kushtet e konkurrencës së pandershme.

Paditësja S.M është regjistruar si person fizik me vendimin nr.21, datë 27.01.2003 të Gjykatës dhe pranë Degës Tatimeve Gjirokastër me NIPT K32508662 F për ushtrim aktiviteti privat "shërbim interneti" në qytetin e Gjirokastrës. Më datë 16.09.2005 paditësja është pajisur me licencën përkatëse nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve, duke u përcaktuar dhe kushtet specifike të ushtrimit të këtij aktiviteti.

I padituri P. B ofron shërbim interneti në qytetin e Gjirokastrës.

Mbi ankimin e paditëses, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve ka inspektuar subjektin P. B më datë 07.04.2006 dhe ka konstatuar se i padituri ofronte shërbim interneti, për të cilin ishte regjistruar në Degën e Tatimeve Gjirokastër me NIPT K35121605V, por nuk ishte pajisur me licencë nga Enti Rregullator. Për mungesë të licencës grupi i inspektimit i ka ndërprerë përdorimin e Stacionit Satelitor deri në pajisjen me të. I padituri është pajisur me licencën përkatëse më datë 09.06.2006, në të cilën janë përcaktuar dhe kushtet specifike të shfrytëzimit të licencës.

Paditësja S.M me pretendimin se i padituri për periudhën që ka kryer aktivitet privat, shërbim interneti i pa pajisur me licencë nga ERT, si rezultat i konkurrencës së pandershme i ka shkaktuar një dëm ekonomik, me padinë e datës 25.09.2006, bazuar në nenet 638/3 dhe 639 të K.Civil, ka kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar dhe ndalimin e aktivitetit.

Gjkata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me vendimin nr.210, datë 09.03.2007, ka vodosur: *Rrezimin e padisë së paditëses*.

Gjkata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr.213, datë 30.05.2007, ka vodosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr.210, datë 09.03.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër*.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në seancën e datës 01.02.2011, ka vodosur dërgimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikim të praktikës gjyqësore.

Jepni përgjigjen e pyetjeve të shtruara për diskutim:

⁵ Vendimi Unifikues i GJL Nr. 3, datë 29.03.2012.



1. Cili është roli që duhet të luajë gjykata, veçanërisht në procesin e identifikimit të objektit të mosmarrëveshjes që duhet të shqyrtojë dhe të zgjidhë, pa cenuar të drejtën e disponimit të palëve që e kanë vënë atë në lëvizje? (5 pikë)
2. Si lidhet shkaku me objektin e padisë? Si lidhet shkaku i padisë me bazën ligjorfe të saj? Në çfarë raporte qëndrojnë "ajo që kërkohet nga palët" me atë që jepet nga gjykata"? (10 pikë)
3. A duhet të lidhet përgatitja dhe më pas gjykimi e zgjidhja e çështjes vetëm mbi atë që formalisht shkruhet dhe që në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë emërtohen si "objekt i padisë" dhe "baza ligjore"? (5 pikë)
4. Cili është fati i gjykimit, nëse ju jeni gjyqtari që do të rishqyrtomi cështjen në shkallë të parë? (15 pikë)
5. Si e ka zgjidhur dhe çfarë ka unifikuar Gjykata e Lartë në këtë rast? (15 pikë)

Shkaktohet se sot është dëgjimi i një përgjigjeje që ka qenë e vlefshme, por që nuk ka qenë e vlefshme.

Shkaktohet se sot është dëgjimi i një përgjigjeje që ka qenë e vlefshme, por që nuk ka qenë e vlefshme. Në këtë rast, që është dëgjimi i një përgjigjeje që ka qenë e vlefshme, por që nuk ka qenë e vlefshme, këtë përgjigjeje nuk mund të bëhet e vlefshme. Në këtë rast, që është dëgjimi i një përgjigjeje që ka qenë e vlefshme, por që nuk ka qenë e vlefshme, këtë përgjigjeje nuk mund të bëhet e vlefshme. Në këtë rast, që është dëgjimi i një përgjigjeje që ka qenë e vlefshme, por që nuk ka qenë e vlefshme, këtë përgjigjeje nuk mund të bëhet e vlefshme.

Shkaktohet se sot është dëgjimi i një përgjigjeje që ka qenë e vlefshme, por që nuk ka qenë e vlefshme.

Shkaktohet se sot është dëgjimi i një përgjigjeje që ka qenë e vlefshme, por që nuk ka qenë e vlefshme. Në këtë rast, që është dëgjimi i një përgjigjeje që ka qenë e vlefshme, por që nuk ka qenë e vlefshme, këtë përgjigjeje nuk mund të bëhet e vlefshme. Në këtë rast, që është dëgjimi i një përgjigjeje që ka qenë e vlefshme, por që nuk ka qenë e vlefshme, këtë përgjigjeje nuk mund të bëhet e vlefshme. Në këtë rast, që është dëgjimi i një përgjigjeje që ka qenë e vlefshme, por që nuk ka qenë e vlefshme, këtë përgjigjeje nuk mund të bëhet e vlefshme.

Shkaktohet se sot është dëgjimi i një përgjigjeje që ka qenë e vlefshme, por që nuk ka qenë e vlefshme. Në këtë rast, që është dëgjimi i një përgjigjeje që ka qenë e vlefshme, por që nuk ka qenë e vlefshme, këtë përgjigjeje nuk mund të bëhet e vlefshme. Në këtë rast, që është dëgjimi i një përgjigjeje që ka qenë e vlefshme, por që nuk ka qenë e vlefshme, këtë përgjigjeje nuk mund të bëhet e vlefshme.

Shkaktohet se sot është dëgjimi i një përgjigjeje që ka qenë e vlefshme, por që nuk ka qenë e vlefshme. Në këtë rast, që është dëgjimi i një përgjigjeje që ka qenë e vlefshme, por që nuk ka qenë e vlefshme, këtë përgjigjeje nuk mund të bëhet e vlefshme.

Shkaktohet se sot është dëgjimi i një përgjigjeje që ka qenë e vlefshme, por që nuk ka qenë e vlefshme. Në këtë rast, që është dëgjimi i një përgjigjeje që ka qenë e vlefshme, por që nuk ka qenë e vlefshme, këtë përgjigjeje nuk mund të bëhet e vlefshme.

Shkaktohet se sot është dëgjimi i një përgjigjeje që ka qenë e vlefshme, por që nuk ka qenë e vlefshme. Në këtë rast, që është dëgjimi i një përgjigjeje që ka qenë e vlefshme, por që nuk ka qenë e vlefshme, këtë përgjigjeje nuk mund të bëhet e vlefshme.

Shkaktohet se sot është dëgjimi i një përgjigjeje që ka qenë e vlefshme, por që nuk ka qenë e vlefshme.



Prokuroria vs E.K. dhe R.I.

Në datë 24.09.2011, rreth orës 17³⁰, i pandehuri R.I. ka njoftuar policinë gjyqësore se, në vendin e biznesit të tij në fshatin Gajtan (Shkodër) është vetëvrasër me pistoletë shtetas L.J., i punësuar si rojëtate. Viktima kishte lënë në vendngjarje një letër ku ai shkruante: "Mos të gjykohet njeri per muad". Në këtë letër ishte përfthuar edhe një gjurmë papilare, e cila rezultoi se i përkiste viktimës. Në vendin e ngjarjes, pranë viktimës, ishte gjetur edhe një pistoletë e mbushur, ndërkohë që vdekja e shtetasit L.J. ishte shkaktuar nga të shtënat me çifte, e cila nuk u gjet në vendin e ngjarjes, pasi ishte fshehur nga i pandehuri R.I. në një vend tjeter që u zbulua nga policia gjyqësore.

I pandehuri R.I. është kushëri me bashkëtëpandehurin, E.K. Ky i fundit kishte rreth një vit që kishte kërkuar të fejohej me vajzën e mitur (më pak se 16 vjeç) të viktimës L.J. Kjo kërkesë kishte hasur në kundërshtimin e prindërve të vajzës, jo vetëm për shkak të moshës, por edhe të faktit që ajo mësonte, ndaj ata kishin menduar ta shkollonin më tej. Me gjithë refuzimin e familjes së vajzës, i pandehuri E.K. ka vazhduar të këmbëngulë në kërkesën e tij, madje duke angazhuar edhe familjarë të tjerë. Për më tepër, dy ditë përpëra ngjarjes, i pandehuri E.K. kishtë shkuar në vendin ku punonte viktima, ku kishte bërë debat me të duke e kërcënuar me fjalët: "...më ke borxh, pasi me ke mbajt tash një vit pas kësaj pune...". Duke u larguar i pandehuri e kishte kërcënuar përsëri viktimën, duke qëlluar me armë në ajër.

I pandehuri E.K., duke u ndier "i fyter" nga refuzimi, pasi dështoi në të gjitha format e presionit ndaj viktimës L.J., e ka vrarë atë, në vendin e punës. Për të humbur gjurmët e krimtit, i pandehuri L.K., ka ndryshuar gjurmët e krimtit, duke u përpjekur ta paraqesë si vetëvrasje, por alibia e tij nuk ka funksionuar, jo vetëm nga të dhënat që u përfthuan nga provat, por edhe nga përgjimi ambiental i realizuar ndërmjet të pandehurve, ku i pandehuri R.I. pranoi që e kishte marrë çiften dhe e kishte fshehur, duke ia treguar më pas policisë gjyqësore vendndodhjen.

Pyetje për pergjigje:

1. Nga të dhënat e kazusit, a mendoni se ka bashkëpunim ndërmjet të pandehurve në vrasjen e viktimës L.J? **(10 pikë)**
2. Si do ta kualifikonit vrasjen e kryer përmbi motivin e kësaj ngjarje? **(20 pikë)**
3. Njoftimi i bërë nga R.I. në policinë gjyqësore a përbën vepër penale dhe nëse po a është kryer në bashkëpunim me të pandehurin E.K? **(20 pikë)**

